



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

# INTERVENIMI ME KOSTO TË ULTË

*Mbrojtja e trashëgimisë kulturore me  
buxhet të vogël*

Financuar nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij – CHwB, Zyra në Prishtinë





Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

# **INTERVENIMI ME KOSTO TË ULTË**

*Mbrojtja e trashëgimisë kulturore me  
buxhet të vogël*

Nëntor 2009, Prizren & Prishtinë

**Botues**

Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe – EC Ma Ndryshe

**Financuar nga**

Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij – CHwB, Zyra në Prishtinë

**Disenj, ballina dhe faqosje**

Krenar Basha

**Shtypi**

Night Design Studio

**Tirazhi**

500 kopje

## **PËRMBAJTJE**

Përmbledhje Ekzekutive  
Për projektin  
Hulumtimi i dytë (metodologjia)

Hyrje

### **PJESA I – Analizat**

Teknikat e intervenimit me kosto të ultë

*Sali Shoshi, Drejtor i Misionit për Kosovë i Fondacionit Suedez Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)*

Restaurimi i kullës “Hoxhaj” - Junik (Intervenim me kosto te ultë)

*Betim Vitija, ba.ark., Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)*

### **PJESA II – Përfundim dhe Rekomandime**

Përfundim

Rekomandime

### **PJESA III – Rezultatet e anketës me interpretime**

Për EC Ma Ndryshe

## **Përmbledhje Ekzekutive**

Përgjatë dhjetë viteve të pas-luftës Prizreni përjetoj degradimin më të madh përgjatë gjithë historisë së ekzistencës së këtij qyteti. Ndër tjerash, qyteti pësoi shkatërrimin më të madh të objekteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, ndërsa paralelisht urbanizimi i gabueshëm, kaotik dhe i egër e shndërruan këtë qytet në diçka që nuk kishte qenë asnjëherë më parë – në një qendër të paorganizuar, të betonizuar dhe deri diku të shëmtuar jetese. Arsyet që na shpjen në këtë degradim, ndonëse mjaft të fuqishme, asesi nuk e meritojnë një nivel justifikues të vëmendjes. Mbi të gjitha, një luftë e përhershme mes përgjegjësve të kësaj gjendjeje për ta hedhur fajin në anën tjetër, ka kontribuar konsiderueshëm në përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme të trashëgimisë kulturore në këtë qytet. Në ciklin e përgjegjësisë për këtë degradim dhe shkatërrim bëjnë pjesë të gjithë, nga vetë qytetarët deri tek qeveria lokale. Derisa trashëgimia kulturore asnjëherë nuk ishte prioritet i qeverisë lokale në dhjetë vitet e fundit në Prizrenit dhe derisa qytetari ballafaqohet me një realitet mjaft sfidues socio-ekonomik, shoqëria civile e qytetit (ndonëse në numër të vogël dhe kapacitet të kufizuar) përpjekjet e veta asnjëherë nuk i dërgoi përtej veprimit vetëdijesues për shkatërrimin që po ndodhte. Në këtë mes, ndërtimet e reja dhe aktiviteti afarist po lulëzonte me shpejtësi marramendëse. Kur kësaj ia shtojmë edhe interesimin e donatorëve të huaj në çështje tjera de shumë pak në trashëgimi kulturore, atëherë realiteti i sotëm pa dyshim se është larg nivelit të dëshirueshëm.

Jemi në një moment kritik për të ardhmen e trashëgimisë kulturore të qytetit të Prizrenit, por edhe të Kosovës në përgjithësi. Jemi në momentin e duhur për të promovuar dhe akovuar për mënyra alternative për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Derisa në një nga dokumentet e kaluara të politikave, EC Ma Ndryshe so një veprim konkret rekomandonte punën vullnetare në fushën e kulturës, dokumenti të cilin po e lexoni avokon për “intervenimin me kosto të ultë”, si një mekanizëm konkret dhe mobilizues për të gjithë aktorët relevantë në këtë fushë. Në bazë të anketës së realizuar në këtë hulumtim, del se pjesa më e madhe e qytetarëve nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për konceptin dhe mundësinë e intervenimit me kosto të ultë. Në fakt, rreth 60% e qytetarëve të nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për intervenimin me kosto të ultë në trashëgimi kulturore janë rezultat i mungesës së politikave kreative publike në nivel lokal dhe qendror në Kosovë dhe paralelisht mungesë iniciative e shoqërisë civile e cila më shumë është koncentruar në ngritjen e çështjeve alarmante rreth degradimit të vlerave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, se sa në pormovimin dhe ofrimin e modeleve konkrete të veprimit për mbrojtjen e këtyre objekteve nga degradimi i vazhdueshëm (mëtejshëm). Ndërsa, kur jemi tek gatishmëria individuale e qytetarëve për të investuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (në këtë rast në shtëpitë e vjetra të Prizrenit) vërehet një disponim mjaft i mirë, i cili paraqet bazë të mirë për ndërmarrjen e veprimeve mobilizuese me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shtëpive të vjetra të Prizrenit për qëllime turistike (bad & breakfast dhe vizita).

Ashtu siç sugjerojnë edhe dy analizat e ekspertëve të paraqitur në këtë publikim, arkitektët dhe konservatorët duhet të jenë më inovativ duke krijuar mundësi të reja në konservim, duke e shndërruar konservimin në një aktivitet të realizueshëm për të gjithë pronarët dhe duke tentuar që kostoja e konservimit të jetë e njëjtë me ndërtimin

konvencional. Përdorimi i kësaj qasjeje do të ndikonte që numri i ndërtesave të cilat do të mbroheshin do të ishte shumë herë më i madh më atë që është sot. Në këtë mënyrë do të kontribuonim drejtpërdrejtë edhe në shtimin e atraktivitetit turistik të qyteteve dhe fshatrave tona, duke e shndërruar vernakularen e Kosovës në vend të vizitueshëm për turistin e huaj. Paralelisht, nuk ka dyshim se qëllimi madhor afatgjatë është përcjellja e këtyre objekteve (shtëpive tradicionale) tek gjeneratat e ardhshme.

Rekomandimi kryesor që del nga kjo analizë përkon me mobilizimin institucional mes aktorëve relevantë në nivel lokal. Intervenimi me kosto të ultë, përveç komponentës profesionale (teknikat e realizimit të intervenimit me kosto të ultë) duhet të stimulojë edhe politika kreative për bashkëfinancim të këtyre intervenimeve. Dhe këto veprime të përbashkëta do të jenë mjaft efektive në restuarimin e shtëpive të vjetra të Prizrenit, ku kërkohet bashkëveprim i qeverisë lokale, pronarëve privatë, komunitetit të biznesit, donatorëve tjerë dhe shoqërisë civile. Rezultatet e këtij veprimi do të shfaqen në një interval të shkurtër kohor, ndërsa kjo do të sjellte promovim të këtij modeli të bashkëpunimit dhe intervenimit me kosto të ultë dhe të ndarë, për t'u aplikuar në të ardhmen edhe në objekte tjera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore.

## Për projektin

Hulumtimi mbi intervenimin me kosto të ultë është i dyti në serinë e hulumtimeve mbi çështje të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, të cilat po i realizon EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare për vendimmarrje në këtë fushë. Projekti përkrahet financiarisht nga CHwB zyra në Prishtinë dhe paraqet një përpjekje serioze për mobilizimin e aktorëve të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në komunën e Prizrenit për rritjen e bashkëpunimit mes qeverisë lokale dhe qytetarëve (shoqërisë civile) dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura për sfidat më të mëdha në këtë fushë.

Përveç themelimit të mekanizmave të komunikimit dhe partneritetit të përhershëm dhe të institucionalizuar (Forumi i Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit), projekti synon të avokojë për politika më të mira publike në nivel lokal (por edhe qendror) në trashëgiminë kulturore, përmes serisë së analizave të politikave. Hulumtimi (analiza) pasues i këtij projekti ka të bëjë me trashëgiminë fetare dhe diversitetin kulturor të Prizrenit, duke u munduar të analizojë të vertetën e marrëdhënieve mes besimeve dhe kulturave të ndryshme dhe njëherit duke e promovuar modelin e suksesshëm të komunikimit dhe mirëkuptimit që ekziston me shekuj në këtë qytet.

## Hulumtimi i dytë (metodologjia)

Ky është hulumtimi i dytë i serisë së hulumtimeve në kuadër të këtij projekti dhe synon të avokojë për promovimin dhe përdorimin e metodave të intervenimit me kosto të ultë, mbi bazën e rezultateve dhe rekomandimeve të këtij dokumenti (udhëzuesi). Për qëllime të këtij hulumtimi është përdorur metoda e hulumtimit sasior ku si instrument kryesor është Pyetësori i standardizuar që në vete ngërthen pyetje bazë për të matur njohuritë e qytetarëve të Prizrenit mbi gjendjen aktuale të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, mundësitë për tejkalimin e gjendjes së vështirë, metodat e intervenimit me kostë të ultë, bashkëpunimin e aktorëve për të promovuar këtë qasje dhe gatishmërinë e qytetarëve të Prizrenit për të qenë pjesë e iniciativave dhe veprimeve që kanë për qëllim mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore përmes metodave që reduktojnë koston e intervenimit (riparim, restaurim, konservim, etj.) në këto objekte. Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë gjithsej 127 pyetësorë me qytetarët e Prizrenit (përqindje statistikisht sinjifikante), derisa hulumtimi ka përdorur edhe dy fokus-grupe për t'i konsultuar aktivistët e shoqërisë civile dhe njohësit tjerë të çështjes së trajtuar. Në hulumtim janë përfshirë qytetarë nga mosha 16-60 vjet, me ndarje 90% qytet dhe 10% fshat, 40.2% të gjinisë mashkullore dhe 59.8% të gjinisë femërore.

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	76	59.8	59.8	59.8
	Mashkull	51	40.2	40.2	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

## Hyrje

Transicioni shtet-formues i Kosovës, deri tani u dëshmuar mjaft i pamëshirshëm ndaj trashëgimisë kulturore të vendit. Përveç faktit që trashëgimia kulturore mbeti poshtë në listën e prioriteteve shtetërore të Kosovës (si në nivel qendror ashtu edhe lokal), edhe në momentet kur ajo ishte temë dominante, shkaktare ishte pikërisht tejpoltizimi i kësaj teme dhe si pasojë rezultatet gjithnjë destruktive për aspektin vleror dhe mbrojtës të saj. Retorikës së zakonshme për mungesë buxheti në politika zhvillimore, nuk i ka shpëtuar as trashëgimia kulturore. Për më tepër, urbanizimi kaotik i pas-luftës ishte fatal për fatin e shumë objekteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në shtetin tonë. Një ndër qendrat që pësuan më së shumti ishte pikërisht qendra më neuralgjike e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Prizreni u shndërrua në një punëtori të madhe ndërtimore, ku kriteri i vetëm që nuk merrej fare parasysh ishte dimensionimi kulturor i ndërtimit dhe planifikimit. Një logjikë e mbrapshtë, por gjithsesi dominante e këtyre viteve sugjeronte se një shtëpi e vjetër duhej rënuar për të ndërtuar në vend të saj godinën e re, e cila do ta ketë mirëmbajtjen më të lirë. Gjithnjë e më pak njerëz kanë prirje për të investuar në restaurimin e shtëpive të tyre të vjetra (tradicionale). Dhe kjo situatë, pa fajin e vetë pronarëve, shkaktohet në rend të parë nga neglizhenca totale e qeverisë qendrore dhe lokale, të cilat nuk ndërmarrin politikave efektive publike për mbrojtjen e këtyre vlerave.

Në rastet kur buxheti publik është i kufizuar dhe nuk ofron shumë mundësi, zgjidhja duhet kërkuar në metodat alternative të veprimit. Institucionet qendrore të Kosovës duhet me urgjencë të miratojnë dhe zbatojnë legjislacion për njohje zyrtare të punës vullnetare, ndërsa rëndësi e veçantë duhet kushtuar kanalizimit të potencialit vullnetar në kulturë (sidomos në trashëgimi kulturore). Paralelisht, siç sugjeron edhe ky dokument i politikave, duhet të punohet në promovimin dhe zbatimin e teknikave të intervenimit me kosto të ultë, kur rol dhe përgjegjësi kanë të gjithë aktorët relevantë, sidomos në nivel lokal. Siç do të lexoni edhe në vijim, shtëpitë tradicionale janë ajo pjesë e trashëgimisë kulturore, ku mund të fillohet me zbatimin e teknikave të intervenimit me kosto të ultë, në mënyrë që ky model të gjej aplikim edhe në objekte tjera të rëndësishme. Bashkëpunimi i duhur (sidomos në aspektin e financimit) për realizimin e intervenimit me kosto të ultë mes qeverisë lokale, pronarëve privatë, komunitetit të biznesit, donatorëve të jashtëm dhe shoqërisë civile, është parakusht i domosdoshëm për jetësimin e projekteve dhe programeve mbrojtëse dhe promovuese të trashëgimisë kulturore.

Institucionet qeveritare (lokale dhe qendrore) duhet të tejkalojnë retorikën e mungesës së buxhetit. Shoqëria civile duhet të kalojë nga qasja a alarmimit për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore në promovim të veprimit direkt. Komuniteti i biznesit duhet ta shndërrojë mentalitetin afarist “esnaf” (të brendshëm) në turizëm kulturor (të jashtëm). Donatorët e jashtëm duhet të dizajnojnë skema specifike grant-dhënëse për qytete dhe fshatra të Kosovës, duke u fokusuar psh. në Prizren, në fushën e trashëgimisë kulturore. Dhe përfundimisht pronarët e shtëpive tradicionale (në Prizren dhe vendet tjera të Kosovës) duhet të tregohen më proaktivë në gjetjen e mundësive për restaurimin e shtëpive të tyre. Funksionimi i këtij cikli bashkëpunimi do të jetë vendimtar për futjen në zbatim të teknikave të intervenimit me kosto të ultë, si një metodë kreative dhe alternative, që ofron zgjidhje për trashëgiminë kulturore të vendit në rrethanat aktuale.



## **PJESA I – Analizat**

### **Teknikat e intervenimit me kosto të ultë**

Sali Shoshi, Drejtor i Misionit për Kosovë i Fondacionit Suedez Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)\*

Konservimi i ndërtesave historike është një proces i ndërlikuar teknik dhe teknologjik i cili ka për qëllim ruajtjen e vlerave kulturore të ndërtesave dhe përshtatjen e tyre në kushtet e reja. Monumentet historike (ndërtesat) janë të ndërtuar në kohë të caktuar në të cilën janë aplikuar teknika dhe materiale tradicionale tipike për kohën e ndërtimit. Përpunimi i drurit dhe gurit apo përzjerja e llaçit gëlqeror ka evoluar në periudha të ndryshme kohore dhe jo gjithmonë këto teknika janë përcejllur deri në ditët e sotit. Aplikimi i materialeve të reja dhe teknikat bashkëkohore ka ndikuar në zhdukjen e shpejtë të mjeshtërive të vjetra. Në Kosovë ky fenomen ka filluar diku në vitet e 70ta. Sot menaxherët kanë probleme në gjetjen e mjeshtreve të cilët aplikojnë teknikat e vjetra. Edhe kompanitë ndërtimore, për shkak të tregut, janë më tepër të fokusuar në teknikat moderne.

Në anën tjetër shumë institucione ndërkombëtare të thirrura për përkujdesje ndaj trashëgimisë kulturore vazhdojnë të organizojnë trajnime dhe edukime në nivele të ndryshme profesionale dhe akademike. Ekzistojnë shumë programe nacionale dhe rajonale të cilat kanë për synim ringjalljen e teknikave tradicionale në mënyrë që të ndërtohen kapacitete dhe resurse që do të jenë të afta të marrin mbi vete barrën e restaurimit dhe konservimit të ndërtesave. Qasja në këto programe është e rregulluar përmes marrëveshjeve bilaterale dhe rajonale të vendeve dhe institucioneve të specializuara siç janë UNESCO, ICOMOS etj

Një sfidë e përbashkët e konservimit të monumenteve mbetet edhe revitalizimi ose funksioni i ri me qëllim që të rikthehet jeta në ndërtesa monument. Revitalizimi synon që të krijohen kushte për shfrytëzim adekuat duke siguruar që ndërtesat gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur vetveten. Në këtë kuadër është e nevojshme që ndërtesat të iu përshtatën nevojave të reja duke lejuar vendosjen e instalimeve të reja elektrike, sanitare, të ngrohjes në mënyrë që ndërtesa dhe hapësirat e saj të jenë e konkurruese në treg, sidomos në industrinë e turizmit kulturor

Shih për këtë ekspert dhe organizata ndërkombëtare kanë hartuar dhe adaptuar dokumente të rëndësishme në të cilën janë definuar një listë kriteresh se si i qasemi konservimit dhe cilat janë masat që duhet të ndërmerren për tu siguruar që vlerat janë ruajtur. Një ndër dokumentet më të rëndësishme është Karta e Venedikut (1964) dhe Konventa e Burra.

Në revitalizim dhe në përgjithësi në konservim të monumenteve një ndër çështjet me të rëndësishme e cila ndërlidhet edhe me Kosovën është përdorimi i materialeve bashkëkohore. Shpesh ekspertët kanë opinion të ndryshme se ku është kompromisi në mes të kontekstit historik dhe ndërhyrjeve bashkëkohore.

Në nenin 10 të Kartës së Venedikut thuhet që:

*Aty ku teknikat tradicionale dëshmojnë si joadekuate, konsolidimi i monumentit mund të arrihet me përdorimin e cilës do teknikë moderne të konservimit dhe ndërtimit, efikasiteti i së cilës është treguar me të dhëna shkencore dhe është vërtetuar në praktikë.*

Në nenin 9 thuhet:

*...çfarëdo pune shtesë që është e domosdoshme duhet të jetë e dallueshme prej kompozicionit artistik dhe duhet të mbajë vulën e bashkëkohores. Restaurimi në çdo rast duhet të paraprihet dhe pasohet me studim arkeologjik e historik të monumentit.*

Në Kosovë ekziston një tendencë në mes të arkitektëve konservatorë për të rikthyer ndërtesën sa më shumë që është e mundur në gjendjen fillestare edhe në ato raste kur nuk ka dokumentacion. Një qasje e tillë na qon në spekulim komprometues duke cenuar autenticitetin e objektit dhe duke lejuar që vëzhguesit e ardhshëm të ndërtesës të mos jenë në gjendje të identifikojnë shtresat autentike në bazë të periudhave kohore.

Qellim i revitalizimit në kushtet e reja është që të ruhen autenticiteti mbi objektin duke u veçuar shtresat e intervenuar mirëpo në anën tjetër kjo qasje do të jetë më lehtë e adaptuar për shkak të kostos më të lirë. Materialet e reja dhe standardizimet në përdorim e tyre (psh knufi) do të mundësojnë ndërhyrje të lehtë, të kthyeshme dhe të lirë në objekt. Normalisht që kjo qasje nuk guxon të keq përdoret ose të përdoret jashtë mase: është e mundur në disa raste ende të përdoren teknikat e vjetra të cilat janë më pak të kushtueshme siç është rasti më gëlqeren e shuar e cila ende është e pranishme në tregun kosovar bile me një çmim shumë të lirë.


Nga kjo dua të konkludoj se arkitektët, konservatorët duhet të jenë më inovativ duke krijuar mundësi të reja në konservim dhe duke e shndërruar konservimin në një aktivitet të realizueshëm për të gjithë pronarët dhe duke tentuar që kostoja e konservimit të jetë e njëjtë me ndërtimin konvencional. Përdorimi i kësaj qasjeje do të ndikonte që numri i ndërtesave të cilat do të mbroheshin do të ishte shumë herë më i madh më atë që është sot.

*\* Qëndrimet në këtë shkrim janë personale të autorit*

## Restaurimi i kullës “Hoxhaj” - Junik (Intervenim me kosto te ultë)

Betim Vitija, ba.ark., Trashëgimia Kulturore Pa Kufij (CHwB)

Gjendet në lagjen e ashtuquajtur “Lagjja e Hoxhajve” e njohur edhe si “Lagjja e Tërgovishtës”. Kjo lagje së bashku me lagjet e Berishës dhe Gacaferit e përfaqësojnë bërthamën, përkatësisht pjesën më të vjetër të vendbanimit të Junikut. Në këtë lagje u ndërtuan kullat të cilat ishin më me nam gjatë historisë sikur “Oda e Junikut”, ngase familjet e këtyre lagjeve njiheshin për trimëri, burrëri dhe pleqëri, po ashtu qëndronin më mirë ekonomikisht.



Sikurse edhe shumë kulla tjera, po ashtu edhe kjo kullë pati fatin të digjej gjatë kohës së luftës të vitit 1999. Me rastin e djegies, kulla humbi çdo elementë të drurit. Kjo nënkupton që pas djegies nga kulla mbeten vetëm muret e gurit. Gjendja e kullës vazhdon të jetë e tillë deri në vitin 2009 kur nëpërmes marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të Kuvendit Komunal të Junikut, pronarit të kullës dhe CHwB-së (Cultural Heritage Without Borders) vendoset që kulla të restaurohet pasi që ajo luan rol të rëndësishëm në historinë e Junikut.

Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese të len të kuptohet se kulla gjatë jetës së saj ka pasur ndërhyrje të shumta në aspektin funksional-arkitektonik gjë që rezulton me humbjen e shumë elementeve autentike të kullës.




Fatmirësisht nga intervenimi i bërë rreth vitit 1975 (sipas pronares së kullës) me ç'rast mureve perimetrike të kullës i vihet një kurorë e betonit të armuar, gjë që i bënë muret e kullës të jenë me kompakte dhe të qëndrojnë deri në ditët e sotme, pavarësisht djegies së vitit 1999.


Në mungesë të të dhënave për gjendjen e me hershme të kullës, po ashtu edhe nga dobësimi i mureve nga ekspozimi shumë i gjatë ndaj kushteve të ndryshme atmosferike natyrore u paraqit e nevojshme që të krijohet një strukturë konstruktive përbrenda mureve perimetrike të kullës në mënyrë që ajo të jetë e pavarur nga muret ekzistuese e në të njëjtën kohë të bëjë të mundur vendosjen e etazheve si dhe përkrahjen e konstruksionit të kulmit.

Pra brenda mureve perimetrike të kullës janë gërmuar gropat e themeleve në të cilat to të vihen shtyllat që do të përkrahin peshën e strukturës së re. Gjithsej janë vendosur nëntë (3x3) shputa të themeleve me dimensione 70x70x80, në to është vendosur edhe elementi metalik i cili do të shërbej për shtangimin e shtyllës me drurin. Vlen të përmendet se në mes mureve të gurit edhe themelit të ri është vendosur një shtresë ndarëse (stiropor) në mënyrë që shputat të jenë elementë të veçanta pa i cenuar themelet e vjetra të kullës. Nëntë shtyllat paraqiten në përdhese dhe katin I. Ndërsa në katin II bartën vetëm tri shtyllat e mesme paralel me murin që i ndanë odën me divanhanën.

Themelet:




Detali i shputës së themelit:




Funksioni i është përshtatur kërkesave të shfrytëzuesve të ardhshëm të kullës. Në përdhese, pjesën me të madhe do ta zë hapësira për shumë qëllime, do të përmbaj dhe erë mbrojtësin së bashku me shkallët që të shpien në katin e I dhe të II. Këto dy hapësira ndahen në mes vete nëpërmes murit të qelqit me konstruksion të aluminit.

Kati i parë përmban në vete tri hapësira për zyre si dhe një nyje sanitare, ndërsa te kati i dytë është ruajtur funksioni autentik i odes së burrave dhe divanhanës. Në të dy katet mund të arrihet nëpërmes shkallëve të atyre të brendshme dhe të jashtme.


Baza e përdheses:




Baza e katit I:



Baza e katit II:



Prerja A-A:




Shtyllat, trajet, konstruksioni meskatësh, konstruksioni i kulmit është i përbërë tërësisht nga druri i bredhit. Ky lloj druri gjenë përdorim të gjerë në tregun kosovar por edhe në vendet tjera prandaj edhe për nga çmimi është shumë më i lirë se druri i gështenjës me të cilin tradicionalisht janë punuar konstruksionet e kullave.

Tjetër veçori e këtij lloj druri është përpunimi shumë më i lehtë se sa ai i gështenjës. Nëse e bëjmë një krahasim të çmimit të drurit të bredhit me atë të gështenjës kemi një dallim prej  $\sim 600 \text{ € / m}^3$

Muret ndarëse, përveç murit që e ndanë oden me divanhanës do të jenë nga profilet e aluminit dhe tabelat e dyfishta të gipsit me një shtresë akustike në mes.

Edhe në dysheme janë zgjedhur materialet ashtu që të jenë të përshtatshme për funksionin e hapësirave ku do të vendosen ato. Në të dy meskatet si shtresë finale to të kemi dërrasat të përkrahura me shtresat e nevojshme që të mos kemi dridhje akustike. Ndërsa në

përdhesë është përdorur tulla si shtresë finale. Arsyeja e mos përdorimit të drurit si shtresë finale e dyshemesë është, sepse ajo do të shfrytëzohet si hapësirë shumë-funksionale që do të thotë se ka frekuentim më të madh dhe dobësia e drurit nëse i ekspozohet lagështisë. Në këtë rast, tulla luan rolin e një materiali natyral, shumë i përafërt me terakotën, i ngrohet, i lirë dhe zëvendësues shumë më i mirë i pllakave të qeramikës apo rrasave të gurëve.



Pikënisje në përpilimin e këtij projekti të restaurimit të monumentit në fjalë, ishte të arrihet deri te një intervenim i cili do t'i përmbahej kritereve të parashtruara në konventën ndërkombëtare për restaurimin dhe konservimin e monumenteve, do të plotësonte nevojat e sotme funksionale për shfrytëzuesit e saj, si dhe duke shfrytëzuar gjithnjë materialet e reja përkundërt atyre tradicionale në mënyrë që të arrijmë deri të një intervenim me kosto të ulët i cili do të mund të aplikohet edhe në restaurimin e monumenteve tjera.

## **PJESA II – Përfundim dhe Rekomandime**

### **Përfundim**

Intervenimi me kosto të ultë është një metodë efektive e parandalimit të veprimeve degraduese ndaj trashëgimisë kulturore. Me një qasje të këtillë, lehtësisht mund të promovohet një teknikë mjaft e qëlluar për mbrojtjen e atyre vlerave të cilat janë në rrezik të zhdukjes, si pasojë e kujdesit të ultë institucional, që shpesh arsyetim kryesor ka kufizimet buxhetore. Në një nga analizat (publikimet) e mëparshme EC Ma Ndryshe, si reagim ndaj realitetit të sotëm socio-ekonomik të Kosovës dhe buxheteve të limituara në fushën e kulturës, ka rekomanduar njohjen zyrtare të punës vullnetare, dhe promovimin e saj sidomos në fushën e kulturës (dhe trashëgimisë kulturore) për të shfrytëzuar një potencial jo të kushtueshëm financiarisht dhe mjaft produktiv si resurs njerëzor. Një tjetër metodë mjaft efektive është edhe “intervenimi me kosto të ultë”, i cili paraqet një mekanizëm konkret të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në nivel lokal. Ndërmarrja e një veprimi të këtillë kërkon mobilizim dhe bashkëpunim institucional dhe ndarja të përgjegjësisë, por edhe të pjesës financiare të veprimeve mbrojtëse. Një nga pjesët ku mund të promovohet ky lloj intervenimi në mënyrë të shpejtë dhe me rezultate efektive është tek shtëpitë tradicionale. Në rastin e Prizrenit, ndonëse një numër i madh i këtyre shtëpive tashmë janë skatërruar, megjithatë ekziston një numër i mirë shtëpish të vjetra, të cilat duhet të bëhen objekt i politikave lokale me qëllime mbrojtëse dhe turistike. Restaurimi i këtyre shtëpive, duke e ndarë financimin në disa pjesë (qeveria qendrore dhe lokale, komuniteti i biznesit, pronarët e shtëpive, donatorët e jashtëm) dhe duke përdorur teknika të restaurimit me kosto të ultë, do të dëshmojë si një ndërmarrje shumë fitimprurëse për qytetin dhe ekonominë familjare. Në të njëjtën kohë, ky model do të gjen zbatueshmëri edhe në objekte tjera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Qytetarët e Prizrenit, të pyetur për këtë mundësi rreth restaurimit të shtëpive të tyre të vjetra, qytetarët shfaqin një disponim të theksuar pozitiv, në rast se shpenzimet e këtij intervenimi ndahen në disa pjesë. Përveç teknikave profesionale të intervenimit me kosto të ultë, bashkëfinancimi i intervenimit do të ishte element komplementar për sukseset e këtyre veprimeve. Gjithsesi, është interes i të gjithëve (institucionet lokale, donatorët, pronarët privatë) që të gjejnë gjuhën e përbashkët për intervenime me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Vernakularja është pjesë më e rrezikuar e trashëgimisë kulturore, dhe e dyta ngase intervenimi me kosto të ultë mund të tregohet mjaft i suksesshëm si model pikërisht në shtëpitë e vjetra të Prizrenit, të cilat mund të valorizohen me buxhet të vogël dhe të përdoren për qëllime turistike, për të sjellë përfitime për ekonominë e qytetit dhe ekonominë familjare. Nuk ka dyshim se qytetarët e Prizrenit janë më se të vetëdijshëm (mbi 90%) për rrezikun që i kanoset shtëpive të vjetra të qytetit. Shikuar në përgjigjet për gatishmërinë e tyre për investim të përbashkët (me kosto të ultë) dhe në nivelin e vetëdijes për rrezikun e shkatërrimit, mund të konkludohet se në Prizren ekziston një mjedis i përshtatshëm për promovimin e politikave të intervenimit me kosto të ultë, për ç’veprim nevojitet koordinimi i qeverisë lokale me shoqërinë civile, të cilët mund ta mobilizojnë komunitetin e biznesit dhe të atraktojnë donatorët e jashtëm për investime.

## **Rekomandime**

Në bazë të rezultateve të anketës, analizave dhe rasteve të studimit mbi intervenimin me kosto të ultë, EC Ma Ndryshe rekomandon këto veprime dhe për këta aktorë:

### *Për qeverinë qendrore*

- Bashkëpunim më i ngushtë mes Divizionit të Trashëgimisë Kulturore (MKRS) dhe Departamentit të Turizmit (MTI) për nxitjen e bashkëpunimit mes aktorëve relevantë në nivel lokal, për intervenime me kosto të ultë, për qëllime mbrojtëse dhe për promovim dhe shërbim turistik, sidomos të shtëpive të vjetra
- Themelimi i një fondi special për intervenim me kosto të ultë dhe për bashkëpunim institucional në nivel lokal, duje e stimuluar konkurrencën mes komunave, të cilat mund të palikojnë në këtë fond në bazë të projekteve të tyre kreative të intgervenimit me kosto të ultë në vlera të trashëgimisë, të parapara për t'u valorizuar turistikisht

### *Për qeverinë lokale*

- Vendosija e trashëgimisë kulturore, sidomos asaj vernakulare në listën prioritare të politikave publike në fushën e kulturës dhe promovimi i veprimeve kreative për intervenime me kosto të ultë
- Themelimi i fondit lokal për intervenime me kostë të ultë në reastuarimin e shtëpive tradicionale të Prizrenit. Përmes këtij fondi, qeveria lokale do të dëshmojë për gatishmërinë e saj për bashkëfinancim, ndësa ekzistimi i këtij fondi do të jetë një shtytje pozitive për mobilizimin e aktorëve tjerë për financim të një intervenimi të caktuar
- Krijimi i forumit lokal të aktorëve të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore, me qëllim ndërmarrjen e veprimeve konkrete për intervenime në objektet e trashëgimisë kulturore

### *Për pronarët privatë*

- Pronarët privatë të shtëpive tradicionale të Prizrenit duhet të tregojnë gatishmëri për bashkëfinancim të intervenimeve restauruese në shtëpitë e tyre dhe t'i ofrojnë shtëpitë e tyre për qëllime turistike (fjetje dhe vizitë)
- Pronarët e shtëpive tradicionale duhet të evitojnë mundësinë e rrënimit të shtëpive të vjetra me qëllim të ndërtimit të shtëpive të reja. Ata duhet të kërkojnë mundësi restaurimi për shtëpitë e tyre në burime të ndryshme dhe jo gjithmonë të presin që të tjerët të ndërmarrin një veprim të këtille

### *Për shoqërinë civile*

- Promovimi i teknikave profesionale të intervenimit me kostë të ultë përmes përgatitjes së broshurave dhe doracakëve informativ dhe vetëdijesues për këto mundësi
- Nxitja e bashkëpunimit mes aktorëve relevantë në nivel lokal për veprime të përbashkëta (bashkëfinancim) në restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore (sidomos shtëpitë e vjetra)
- Avokim tek qeveria qendrore (MKRS dhe MTI) dhe qeveria lokale (DKRS) për krijimin e fondeve të posaçme për intervenime me kosto të ultë



*Për komunitetin e biznesit*

- Pjesëmarrja në investime të përbashkëta për valorizimin turistik të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe organizimi e ofrimi i shërbimeve turistike brenda dhe rreth këtyre objekteve
- Promovim i konceptit të prgjegjësisë sociale të korporatave, duke e shprehur vullnetin e mirë të bizneseve për përkujdesje ndaj trashëgimisë kulturore

*Për donatorët dhe organizatat ndërkombëtare*

- Definimi i prioriteteve për dhënien e granteve dhe donacioneve në bazë të specifikave lokale (qytetet dhe fshatrat)
- Ofrimi i skemave grant-dhënëse në fushën e trashëgimisë kulturore për qytetin e Prizrenit dhe për qytete e fshatra tjera që posedojnë vlera kulturore dhe natyrore
- Pjesëmarrja në programet e intervenimit me kosto të ultë, duke u bërë një nga bashkëfinancuesit e veprimeve me qëllime mbrojtëse në objektet e trashëgimisë kulturore

### PJESA III – Rezultatet e anketës me interpretime

1. A mendoni se kushton shumë (financiarisht) restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	80	63.0	63.0	63.0
	Mesatarisht	34	26.8	26.8	89.8
	Jo	7	5.5	5.5	95.3
	Nuk e di	6	4.7	4.7	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Pa marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të verëdijes dhe informatave mbi trashëgiminë kulturore, qytetarët e Prizrenit janë të bashkuar rreth mendimit se restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore është një veprim financiarisht i kushtueshëm. Ky disponim i respondenteve është një indikator mjaft i qartë i vëmendjes që ata rrjedhimisht ia kushtojnë çështjes së mbrojtjes së objekteve me rëndësi historike dhe kulturore në qytetin e tyre. Kushtueshmëria financiare e veprimeve mbrojtëse krijon paradigmë të fortë deprioritizuese për trashëgiminë kulturore, duke e shtyrë këtë çështje shumë poshtë në listën e nevojave dhe veprimeve tjera më ekzistenciale për përditshmërinë e qytetarëve (psh. punësimi, shërbimet e rregullta publike, cilësia e jetës, etj.).

2. A duhet të shpenzojnë shumë institucionet shtetërore nga buxhetet publike për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	49	38.6	38.6	38.6
	Mesatarisht	63	49.6	49.6	88.2
	Jo	7	5.5	5.5	93.7
	Nuk e di	8	6.3	6.3	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Përgjigjet ndaj pyetjes së parë përforcohen edhe më shumë nga disponimi i shfaqur i qytetarëve të Prizrenit për shpenzimin e parasë publike në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Vetëm 38.6% e qytetarëve mendojnë se institucionet shtetërore duhet të shpenzojnë shumë (ose më shumë) për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

3. A pajtoheni se edhe pronarët privatë të shtëpive të vjetra me vlera historike, kulturore dhe arkitektonike duhet të investojnë në restaurimin dhe mbrojtjen e këtyre shtëpive?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	107	84.3	84.3	84.3

	<b>Jo</b>	20	15.7	15.7	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Kur jemi tek gatishmëria individuale e qytetarëve për të investuar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (në këtë rast në shtëpitë e vjetra të Prizrenit) vërehet një disponim mjaft i mirë, i cili paraqet bazë të mirë për ndërmarrjen e veprimeve mobilizuese me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shtëpive të vjetra të Prizrenit për qëllime turistike (bad & breakfast dhe vizita).

4. Nëse keni shtëpi të vjetra, a jeni më të gatshëm (prirur) për:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	<b>Të investuar në restaurimin e shtëpisë</b>	76	59.8	59.8	59.8
	<b>Të ndërtuar shtëpi të re</b>	49	38.6	38.6	98.4
	<b>Ref/Pp</b>	2	1.6	1.6	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Ndonëse pjesa më e madhe e respondentëve janë përcaktuar për opsionin e restaurimit të shtëpisë së vjetër (tradicionale), megjithatë përqindja e atyre që janë përcaktuar për opsionin e dërtimit të shtëpisë së re është mjaft shqetësuese. Në rast se nuk ndërmeren verime konkrete për mbrojtjen e shtëpive të vjetra të Prizrenit, përqindja e qytetarëve që do të preferojnë ndërtimin e ri në vend të restuarimit, do të shtohet ndieshëm.

5. A është stimulim i mjaftueshëm për pronarin privat të një shtëpie të vjetër nëse një pjesë të mjeteve të restaurimit ia sigurojnë institucionet shtetërore ose donatorët tjerë?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	<b>Po</b>	59	46.5	46.5	46.5
	<b>Mesatarisht</b>	54	42.5	42.5	89.0
	<b>Jo</b>	14	11.0	11.0	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Një nga qëllimet kryesore të këtij hulumtimi është promovimi i idesë dhe mundësisë për intervenime të përbashkëta për mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Konkretisht, të pyetur për këtë mundësi rreth restaurimit të shtëpive të tyre të vjetra, qytetarët shfaqin një disponim të theksuar pozitiv, në rast se shpenzimet e këtij intervenimi ndahen në disa pjesë. Përveç teknikave profesionale të intervenimit me kosto të ultë, bashkëfinancimi i intervenimit do të ishte element komplementar për sukseset e këtyre veprimeve. Gjithsesi, është interes i të gjithëve (institucionet lokale, donatorët, pronarët privatë) që të gjejnë gjuhën e përbashkët për intervenime me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.

6. A keni dëgjuar për intervenimin (restaurimin) me kosto (buxhet) të ultë?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	52	40.9	40.9	40.9
	Jo	75	59.1	59.1	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Nuk është befasues akti që pjesa më e madhe e qytetarëve nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për konceptin dhe mundësinë e intervenimit me kosto të ultë. Në fakt, rreth 60% e qytetarëve të nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për intervenimin me kosto të ultë në trashëgimi kulturore janë rezultat i mungesës së politikave kreative publike në nivel lokal dhe qendror në Kosovë dhe paralelisht mungesë iniciative e shoqërisë civile e cila më shumë është koncentruar në ngritjen e çështjeve alarmante rreth degradimit të vlerave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, se sa në promovimin dhe ofrimin e modeleve konkrete të veprimit për mbrojtjen e këtyre objekteve nga degradimi i vazhdueshëm (mëtejshëm).

7. A pajtoheni se shtëpitë e vjetra të Prizrenit janë në rrezik të zhdukjes nga moskujdesi?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	119	93.7	93.7	93.7
	Jo	8	6.3	6.3	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Theks i veçantë në këtë hulumtim dhe pyetësor iu kushtua shtëpive të vjetra të Prizrenit për dy arsye. E para, ngase vernakularja është pjesë më e rrezikuar e trashëgimisë kulturore, dhe e dyta ngase intervenimi me kosto të ultë mund të tregohet mjaft i suksesshëm si model pikërisht në shtëpitë e vjetra të Prizrenit, të cilat mund të valorizohen me buxhet të vogël dhe të përdoren për qëllime turistike, për të sjellë përfitime për ekonominë e qytetit dhe ekonomitë familjare. Nuk ka dyshim se qytetarët e Prizrenit janë më se të vetëdijshëm (mbi 90%) për rrezikun që i kanoset shtëpive të vjetra të qytetit. Shikuar në përgjigjet për gatishmërinë e tyre për investim të përbashkët (me kosto të ultë) dhe në nivelin e vetëdijes për rrezikun e shkatërrimit, mund të konkludohet se në Prizren ekziston një mjedis i përshtatshëm për promovimin e politikave të intervenimit me kosto të ultë, për ç' veprim nevojitet koordinimi i qeverisë lokale me shoqërinë civile, të cilët mund ta mobilizojnë komunitetin e biznesit dhe të atraktojnë donatorët e jashtëm për investime.

8.1 Renditni sipas rëndësisë (1-5) se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra?/ Komuna e Prizrenit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	1	40	31.5	31.5	31.5
	2	67	52.8	52.8	84.3
	3	8	6.3	6.3	90.6
	4	6	4.7	4.7	95.3
	5	6	4.7	4.7	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

**8.2 Renditni sipas rëndësisë (1-5) se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra? / Ministria e Kulturës**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	60	47.2	47.2	47.2
	2	26	20.5	20.5	67.7
	3	24	18.9	18.9	86.6
	4	14	11.0	11.0	97.6
	5	3	2.4	2.4	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

**8.3 Renditni sipas rëndësisë (1-5) se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra? / Pronarët privatë**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	15	11.8	11.8	11.8
	2	22	17.3	17.3	29.1
	3	53	41.7	41.7	70.9
	4	18	14.2	14.2	85.0
	5	18	14.2	14.2	99.2
	6	1	.8	.8	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

**8.4 Renditni sipas rëndësisë (1-5) se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra? / Shoqëria civile**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
--	--	-----------	---------	---------------	--------------------

Valid	1	9	7.1	7.1	7.1
	2	7	5.5	5.5	12.6
	3	21	16.5	16.5	29.1
	4	66	52.0	52.0	81.1
	5	24	18.9	18.9	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

8.5 Rënditni sipas rëndësisë (1-5) se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra?/ Bizneset					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	6	4.7	4.7	4.7
	2	5	3.9	3.9	8.7
	3	19	15.0	15.0	23.6
	4	21	16.5	16.5	40.2
	5	61	48.0	48.0	88.2
	9	15	11.8	11.8	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Nga përgjigjet e dhëna në pyetjen se kush është përgjegjës për mbrojtjen e shtëpive të vjetra të Prizrenit shihet një “drejtim gisht” mjaft i fuqishëm nga institucionet shtetërore, lokale dhe qendrore. Natyrisht, këto rezultate nuk tregojnë tendencë amnistimi për përgjegjësinë qytetare ndaj mbrojtjes së këtyre vlerave, pasi që në këtë renditje, menjëherë pas institucioneve shtetërore, respondentët iu mveshin përgjegjësinë edhe vetë pronarëve të shtëpive dhe shoqërisë civile, pra vetë qytetarëve të Prizrenit, të cilët janë bashkëpërgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të qytetit të tyre. Rrjedhimisht, edhe bashkëfajtorë për degradimin e këtyre vlerave.

9. A jeni të gatshëm të investoni me kosto të ultë financiare në restaurimin dhe mbrojtjen e objekteve tjera të trashëgimisë kulturore në Prizren?					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	84	66.1	66.1	66.1
	Jo	43	33.9	33.9	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Gatishmëria për të investuar financiarisht në objekte tjera (përveç shtëpive të vjetra) është në nivel të kënaqshëm, në bazë të rezultateve të kësaj pyetjeje. Derisa ekziston një gatishmëri prej 66% për t’u kujdesur për objektet e trashëgimisë kulturore, qeveria lokale e Prizrenit duhet të jetë e vetëdijshme dhe vigjilente për ekzistimin e një mjedisi dhe

gatishmëria të lartë qytetare për të qenë pjesëmarrës direkt në projektet dhe veprimet me qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

<b>10. Sa paraqet pengesë papunësia dhe gjendja ekonomike në restaurimin (mbrojtjen) e shtëpive dhe objekteve me vlera historike, kulturore dhe arkitektonike?</b>					
		<b>Frequency</b>	<b>Percent</b>	<b>Valid Percent</b>	<b>Cumulative Percent</b>
<b>Valid</b>	<b>Aspak</b>	1	.8	.8	.8
	<b>Mesatarisht</b>	24	18.9	18.9	19.7
	<b>Shume</b>	102	80.3	80.3	100.0
	<b>Total</b>	127	100.0	100.0	

Në kontekstin aktual socio-ekonomik të Kosovës dhe të Prizrenit, nuk është për t'u befasuar me përgjigjet rreth ndikimit të papunësisë dhe gjendjes ekonomike në veprime mbrojtëse për trashëgiminë kulturore. Mbi 80% e qytetarëve janë të mendimit se gjendja e tyre financiare është përcaktuese në veprimet e tyre për trashëgiminë kulturore të qytetit, por edhe për vetë shtëpitë e tyre (të vjetra).

## **Për EC Ma Ndryshe**

Organizata Jo-Qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua ne Mars të vitit 2006, nga një grup të rinjesh, kryesisht prizrenas, me përvojë në sektorin jo-qeveritar dhe atë privat. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse, ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore, avancimi i pozitës së rinisë në proceset vendim-marrëse, promovimi i drejtësisë sociale dhe kontribuimi në proceset e integritit të Kosovës në strukturat evropiane nëpërmjet vlerave kulturore, shoqërore, qytetare dhe politike të vendit tonë.

Nëpërmjet punës vullnetare, EC Ma Ndryshe kishte për qëllim kryesor ndryshimin e qasjes së qytetarëve të Prizrenit dhe më gjërë, ndaj vlerave të përbashkëta dhe çështjeve të cilat i takojnë komunitetit. Pjesëmarrja qytetare ishte koncepti themelor i aktivitetit të organizatës, i cili me kohë u fokusua në trashëgimi kulturore dhe kulturë, si dhe kontribut në procesin integrimi europiane. Përveç 13 anëtarëve themelues, qysh në vitin e parë EC Ma Ndryshe mobilizoi një grup të madh vullnetarësh (kryesisht nxënës të shkollave të mesme) të cilët u angazhuan në aktivitetet e saj, sikurse edhe aksione të ndryshme qytetare jashtë ombrellës zyrtare të organizatës.

Në vitin 2007 EC Ma Ndryshe zgjeroi aktivitetin e saj edhe jashtë qytetit të Prizrenit, ndërsa hapi zyre edhe në Prishtinë, pas angazhimit në një numër projektsh të nivelit qendror. Qasja pjesëmarrëse e punës së organizatës ndikoi që EC Ma Ndryshe të krijojë raporte të mira bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe atë qendror, sidomos në aspektin e kontributit në nxitjen e debatit gjithëpërfshirës për çështje të caktuara dhe hartimin e politikave kulturore. Përveç nxitjes së presionit qytetar, ofrimi i alternativave për zgjidhjen e problemeve të caktuara dhe implementimi i tyre ka bërë që EC Ma Ndryshe të jetë partner i besueshëm i qytetarëve dhe vendim-marrësve.

OJQ EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Europës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage, rrjet ky udhëheqës në rajon i kësaj fushe. Gjithashtu, është themeluese dhe udhëheqëse e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, forum ky ku rregullisht takohen të gjithë aktorët relevantë qeveritarë, jo-qeveritare dhe të sektorëve tjerë të fushës nga qyteti i Prizrenit. EC Ma Ndryshe është edhe pjesëmarrëse e rregullt e Forumit për Trashëgimi Kulturore të Kosovës, udhëhequr nga MKRS.

Bazuar në fushat e veprimtarisë së saj, EC Ma Ndryshe ka bashkëpunim të shkëlqyer me organizatat dhe donatorët që merren me trashëgimi kulturore dhe kulturë (CHwB, ATTA, DokuFest, Teatri Oda etj.) dhe integrimi europiane (KCSF, KFOS, EUIRC etj.). Përveç personelit të organizatës (2 punëtorë me orar të plotë pune dhe 2 të tjerë më gjysëm orar), EC Ma Ndryshe ka një rrjet të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët vazhdimisht angazhohen në përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe implementimin e projekteve të ndryshme.

### *Projektet kryesore*

Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009) – qëllimi kryesor i kërrij projekti është krijimi i parakushteve elementare për forcimin e



veprimet qytetar për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore në Kosovë, përmes një seti të veprimeve dhe masave konkrete, me synim mobilizimin e aktorëve kryesor institucional dhe civil për t'i adresuar sfidat dhe politikat zhvillimore në fushën e trashëgimisë kulturore

Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009) – forcimi dhe zhvillimi i politikave kulturore të lidhen me procesin e integrimit evropian dhe arritja e pjesëmarrjes së plotë të Kosovës në Programin Kulturor 2007 – 2013 të DGEC (EU Directorate General for Education and Culture).

Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009) – Deri tani, EC Ma Ndryshe ka organizuar një numër të konsiderueshëm kampesh restaurimi, në të cilët ka kombinuar aktivitete të intervenimit direkt me pjesën e edukimit dhe ngritjes së aftësive të pjesëmarrësve, kryesisht mbi çështjet e vullnetarizmit në trashëgimi kulturore.

Forumet e Hapura Qytetare (2007) – nxitja e kulturës së debatit në Prizren mbi çështjen e rëndësisë vitale për qytetin, respektivisht mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të qytetit dhe rritjen e vetëdijes së përgjithshme për nevojën dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes, kultivimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore so një potencial për zhvillimin e turizmit kulturor në Prizren.

Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 and 2008) – EC Ma Ndryshe ka qenë aktivisht e përfshirë në organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, në partneritet me organizatat tjera jo-qeveritare dhe institucionet shtetërore.

Zambaku i Prizrenit 2006 – në natën e 7 korrikut 2006, në kopshtin veror të kinemasë Lumbardhi në Prizren, në prezencë të rreth 700 spektatorëve dhe në transmetim të drejtpërdrejtë të Radio Televizionit të Kosovës, EC Ma Ndrysha ka organizuar festivalin e këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit”.

#### *Publikimet*

Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008) – qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë informata relevante dhe të domosdoshme për organizatorët (partnerët) e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë, në mënyrë që Kosova të demonstrojë profesionalizëm dhe pajtueshmëri me standardet evropiane të organizimit dhe shënimit të ditëve të trashëgimisë.

Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008) – ky publikim është produkt i projektit “Forumet e Hapura Qytetare” dhe përbëhet nga i) përfundimet dhe rekomandimet kryesore nga debatet, ii) të gjeturat e anketës, dhe iii) analiza mbi potencialin e turizmit kulturor në Prizren.

Prizreni në Retrovizore (krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit) – në këtë prezantim krahasues të qytetit, paraqiten dy fytyrat e Prizrenit, duke i ofruar lexuesit mundësinë e identifikimit të ndryshimeve marramendëse që kanë ndodhur në qytet, përmes krahasimit të fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit.

Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009) – ky është publikimi i parë i serisë së publikimeve në kuadër të projektit “Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore” dhe ka për qëllim ofrimin e rekomandimeve konkrete mbi mënyrën e shfrytëzimit të punës vullnetare për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore.

Intervenimi me kosto të ultë (2009) – ky është hulumtimi i dytë i serisë së hulumtimeve në kuadër të projektit “Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore” dhe synon të avokojë për promovimin dhe përdorimin e metodave të intervenimit me kosto të ultë, mbi bazën e rezultateve dhe rekomandimeve të këtij dokumenti.